



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 14/2017 për ndarjen e bursave, Vendimin nr. 41/01B, të datës 22.05.2020 dhe duke marrë parasysh rrethanat e shkaktuara nga pandemia COVID-19 shpall:

KONKURS

**PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT ELITARË TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE
TË NIVELEVE: BAÇELOR DHE MASTER PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Kushtet dhe kriteret:

1. Për fitimin e bursës së MASHTI-t, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1.Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2.Të kenë përfunduar vitin e parë në studimet BA dhe vitin e parë për studimet MA;
 - 1.3.Të kenë të përfunduar vitet akademike paraprake, pa përsëritje të vitit;
 - 1.4.Të drejtë aplikimi kanë studentët e të gjitha fushave të studimit;
 - 1.5.Të drejtë aplikimi kanë studentët që kanë notën mesatare të studimeve së paku 9.0 të arritur në afatin e provimeve të shtatorit të vitit 2019.

Mënyra e aplikimit:

Duke marrë parasysh rrethanat e shkaktuara nga pandemia COVID-19, MASHTI vendos që aplikimi për këtë vit të bëhet përmes **Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Studentëve** të Universiteteve publike. Studentët duhet të aplikojnë në institucionet ku ata studiojnë. Universitetet publike krijojnë kushtet e nevojshme për të mundësuar aplikimin e studentëve në këto platforma sipas kushteve të këtij konkursi dhe lansojnë konkursin brenda platformave të tyre.

- Aplikimi elektronik do të jetë i hapur nga data 08.06.2020 deri më datë 29.06.2020. Lista përfundimtare e studentëve të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret për të qenë përfitues të MASHTI-t, dorëzohen nga universitetet publike në MASHTI.
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI-t.

Këshilla juridike:

Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI-t, kati përdhësë, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtresa i MASHTI-t.